



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ  
PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019, DATE 29.12.2008  
“KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 dhe nenit 83, pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e

\_\_\_\_\_

**KUVENDI I  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2, bëhen këto ndryshime:

- Pika 5 riformulohet si vijon”

“5. Koalicion është bashkimi i disa partive politike apo “grupimeve politike”, për të konkuruar sëbashku në zgjedhje, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod”.

- Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. “Grupim politik” është njësi organizative zgjedhore që përbëhet nga dy apo më shumë parti politike, të cilat janë rregjistruar në të njëjtin koalicion, dhe që kanë pikpamje, ide, platforma, qëllime e interesa të përbashkëta, të organizuar sëbashku për të kryer të njëjtën veprimtari politiko-elektorale dhe që e shohin të nevojshme për të realizuar më mirë ushtrimin e ndikimit, për rritjen e përfaqësimit të tyre në Kuvendin e Shqipërisë dhe në organet e qeverisjes vendore”.

- Në pikën 20, pas fjalës “koalicionet”, shtohet një fjalë me këtë formulim “grupimet politike”.

## Neni 2

Në nenin 63, pika 1, pas shprehjes “Koalicion partish politike”, shtohen këto fjalë; “si dhe një grupim politik”.

## Neni 3

Në nenin 65 bëhen këto ndryshime:

- Në titullin e këtij neni, pas fjalëve “koalicionet zgjedhore”, shtohen këto fjalë: “dhe i grupimeve politike”

- Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“Për t`u regjistruar si koalicion zgjedhor apo grupim politik, partitë politike duhet të paraqesin në KQZ kërkesën e tyre, e cila duhet të përmbajë dhe deklaratën e nënshkruar nga kryetarët e secilës parti politike, të rregjistruara si subjekte zgjedhore, nëpërmjet së cilës jepet pëlqimi për të marrë pjesë si anëtare e koalicionit apo dhe e grupimit politik. Në rastin e një marrëveshje të tyre, deklarata duhet të përmbajë dhe mënyrën e përfshirjes së një apo më shumë kandidatëve të partive politike të koalicionit apo grupimit politik, në një listë të njërës prej këtyre partive politike, renditjen e tyre sipas rendit shifror, si dhe zotimin për të përmbushur këtë detyrim”.

KQZ konfirmon kërkesën për njohjen dhe rregjistrimin si subjekte zgjedhore të koalicionit si dhe grupimit politik, në bazë të marrëveshjes së tyre. Në këtë rast renditja përfundimtare e kandidatëve të listës shumëemërore zbatohet drejtpërdrejt nga KQZ-ja.

## Neni 4

Neni 67 ndryshohet si vijon:

- Në pikën 2, pas fjalisë së fundit të paragrafit të parë, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Lista e kandidatëve të partive pjesëmarrëse të koalicionit duhet të firmoset nga të gjithë kryetarët e partive politike, anëtare të koalicionit. Në mungesë të firmosjes së kësaj liste nga një apo më shumë kryetarë të partive të koalicionit, kjo listë refuzohet për rregjistrim nga ana e KQZ-së, e cila zbaton ndryshimet në listën përkatëse, në përputhje me përcaktimet në marrëveshjen e deklaratës që është depozituar së bashku me kërkesën e rregjistrimit të koalicioneve zgjedhore.

- Pika 5 riformulohet si vijon:

“Emrat në listën e partisë paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri 1. Numri i kandidatëve në listën shumëemërore të një partie, të regjistruar si subjekt më vete, apo numri i

përgjithshëm i kandidatëve të një koalicioni, nuk duhet të jetë më i vogël se numri i mandateve për Kuvendin apo ato të Këshillit Vendor përkatës, si dhe nuk mund të jetë më i madh se 10% më shumë nga numri i mandateve që do të zgjidhen për Kuvendin apo numrit të mandateve për Këshillin Vendor përkatës. Për një parti pjesëtare të koalicionit, numri i kandidatëve nuk mund të jetë më i vogël sesa gjysma dhe as më i madh se 10% më shumë se numri i përgjithshëm i mandateve për Kuvend, apo Këshillin Vendor përkatës, në rastin e zgjedhjeve lokale.

- Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“ Në rast të vdekjes apo dorëheqjes së kandidatit, jo më vonë se dhjetë ditë para datës së zgjedhjeve, një subjekt zgjedhor mund të zëvendësojë kandidatin brenda një date të caktuar nga KQZ”.

### **Neni 5**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**

**Gramoz RUÇI**